



Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes Erasmus+, në Universitetin Teknologjik të Compiegne, Francë

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 biletarale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Teknologjik te Compiegne (UTC), në Francë.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës).
- **Master i Shkencave** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave:

- Numri i total i bursave/mobiliteteve në dispozicion për këtë thirrje, për nivelin Bachelor dhe Master i Shkencave së bashku është: 4 mobilitete (studente), 6 muaj cdo mobilitet (një semester).

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor dhe Master i Shkencave:

- CV;
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Listë notash të studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit (për studentët Bachelor);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit (për studentët Master i Shkencave);
- Diplomë e nivelit Bachelor (fotokopje, për studentët Master i Shkencave);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze ose franceze);
- Certifikatë e gjuhës franceze, niveli minimal i përcaktuar B2 për aplikim në UTC Bachelor
- Certifikatë e gjuhës angleze, niveli minimal i përcaktuar B2 ;
- Dokumenti Learning Agreement (pasi të shpallen fitues)*.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknologjik te Copmiegne (UTC), lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.



Polytechnic University of Tirana (PUT)

**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**



Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga përgjegjësi i departamentit që ofron programin e studimit, dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim për studentët: deri më 15 Nëntor 2022

Aplikimi kryhet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Dokumentat e cituara më sipër duhet të dorëzohen në hard copy të firmosura dhe të nisen elektronikisht në adresën e email: smaraj@fti.edu.al;

DEKANATI